

QIPRO kundër TURQISË

(kërkesa nr. 25781/94)

10 maj 2001

*heshtja dhe mosveprimi i autoriteteteve shtetërore në lidhje me rastet e
njoitura të zhdukjes së personave përbën shkelje të nenit 2*

I. Faktet kryesore

1. Kjo çështje kishte të bënte me gjendjen që ekzistonte në Qipron veriore që nga fillimi i operacioneve ushtarake në këtë vend nga ana e Turqisë, në korrik dhe gusht 1974 dhe nga ndarja e vazhdueshme e territorit të Qipros që prej asaj kohe. Në lidhje me këtë gjendje Qipro ka pretenduar gjithmonë se Turqia ka shkelur vazhdimisht Konventën në territorin e Qipros së veriut pas miratimit të dy raporteve të Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut në lidhje me dy kërkesa të mëparshme të paraqitura nga ana e Qipros kundër Turqisë.

II. Vendimi i Gjykatës

2. Përpara Gjykatës Qiproja pretendonte shkelje të Neneve 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 13, 14, 17 dhe 18 të Konventës dhe të Neneve 1 dhe 2 të Protokollit 1 të saj. Sipas Qipros këto Nene ishin shkelur për shkak të praktikës administrative në shtetin e paditur. Pretendimet qipriote kishin të bënин me momentet vijuese: zhdukja e personave me origjinë greko-qipriote si dhe e të afërmve të tyre; cenimi i shtëpive dhe pronave të personave të shpërngulur; kushtet e jetesës të greko-qipriotëve në rajonin e Karpas në Qipron veriore; si dhe ankime të turko-qipriotëve, përfshirë anëtarë të komunitetit cigan që jeton në veri të Qipros.

A. Pretendimet paraprake

3. Në lidhje me mohimin e Turqisë për mungesë përgjegjësie në bazë të Konventës në lidhje me pretendimet e ngritura kundër saj, Gjykata ishte e mendimit se faktet mbi të cilat bazoheshin pretendimet e kërkesës ishin brenda juridikzionit të Turqisë sipas kuptimit të Nenit 1 të Konventës dhe për këtë arsyе angazhonin përgjegjësinë e Turqisë në bazë të saj.

B. Në lidhje me themelin e çështjes

a) *zhdukja e personave greko-qipriotë apo e të afërmve të tyre*

4. Provat e sjella përpara Gjykatës nuk arrinin të nxirrin në pah aq sa duhej që të gjithë personat e zhdukur ishin vrarë në rrethana që angazhonin përgjegjësinë e shtetit të paditur dhe për këtë arsyе nuk konstatoi shkelje të Nenit 2 në këtë pikë. Nga ana tjetër, Gjykata konstatoi se ka pasur një shkelje të vazhdueshme të Nenit 2 në lidhje me mosveprimin e autoriteteve të shtetit të paditur për të drejtuar një hetim efektiv në lidhje me vendndodhjen dhe fatin personave greko-qipriotë të cilët ishin zhdukur në rrethana që përbënin kërcënim për jetën.

5. Megjithëse ajo vuri re se nuk ishte evidente që, gjatë periudhës që u mor në analizë, ndonjë nga personat e zhdukur kishin qenë në kushtet e heqjes së lirisë, Gjykata vendosi që ka pasur një shkelje të vazhdueshme të Nenit 5 për shkak të mosveprimit të autoriteteve të shtetit të paditur për të ndërmarrë një hetim efektiv mbi vendndodhjen dhe fatin personave greko-qipriotë të zhdukur në lidhje me të cilët kishte një pretendim të bazuar sipas të cilës ata kishin qenë nën mbikëqyrjen e autoriteteve turke në kohën kur ishin zhdukur.

6. Përsa u përket të afërmve të personave greko-qipriotë të zhdukur, Gjykata vendosi se ka pasur një shkelje me karakter të vazhdueshëm të Nenit 3. Sipas mendimit të saj heshtja e autoriteteve të shtetit të paditur përballë shqetësimëve reale të të afërmve arrinte në nivelin e një ashpërsie që mund të kategorizohej si trajtim çnjerëzor.

b) *banesat dhe pronat e personave të shpërngulur*

7. Gjykata mbajti qëndrimin se ka pasur një shkelje të vazhdueshme të Nenit 8 për shkak të refuzimit për të lejuar kthimin e ndonjë prej personave greko-qipriotë të shpërngulur nga shtëpitë e tyre në veri të Qipros. Për më tepër, Gjykata vendosi se ka pasur një shkelje të vazhdueshme të Nenit 1 të Protokollit 1 për shkak të faktit që pronarëve të pasurive të paluajtshme në veri të Qipros po u mohohej posedimi, gëzimi dhe disponimi i pronave të

tyre si dhe çdo mundësi kompensimi për ndërhyrjen ndaj të drejtës së tyre të pronës. Gjykata vendosi gjithashtu që ka pasur shkelje të Nenit 13 për shkak të mohimit ndaj greko-qipriotëve të larguar nga Qipro e veriut të çdo mjeti efektiv për të kundërshtuar ndërhyrjet me të drejtat e tyre në bazë të Neneve 8 dhe Nenit 1 të Protokollit 1.

- c) *kushtet e jetesës së greko-qipriotëve në rajonin e Karpas në Qipron veriore*
- 8. Gjykata shprehu mendimin se kishte pasur një shkelje të Nenit 9 ndaj greko-qipriotëve që jetonin në veri të Qipros. Gjykata vendosi gjithashtu se kishte pasur shkelje të Nenit 10 në lidhje me këta greko-qipriotë për shkak se librat e shkollës të destinuara për përdorim prej tyre në shkollat fillore i ishin nënshtuar masave të tepruara të censurës.
- 9. Gjykata u shpreh në vijim se ka pasur një shkelje të vazhdueshme të Nenit 1 të Protokollit 1 ndaj greko-qipriotëve që jetonin në veri të Qipros në lidhje me faktin se e drejta e tyre e gëzimit paqësor të pronave të tyre nuk ishte garantuar në rastin e një largimi të përhershëm nga territori në fjalë si dhe për faktin se, në rast vdekjeje, të drejtat e trashëgimisë të personave që jetonin në jug të Qipros nuk njiheshin.
- 10. Gjykata vendosi gjithashtu se ka pasur shkelje të Nenit 2 të Protokollit 1 për shkak se nuk kishte pasur mundësi të përshtatshme shkollimi tetëvjeçar për greko-qipriotët që jetonin në veri të Qipros.
- 11. Në vijim Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 3 të Konventës për shkak se greko-qipriotët që jetonin në zonën e Karpasit në veri të Qipros i ishin nënshtuar një diskriminimi që arrinte deri në trajtim degradues. Ajo vuri në dukje në këtë kuadër se popullsia greko-qipriote e zonës së Karpasit ishte detyruar të jetonte në situata izolimi dhe se anëtarët e saj kontrolloheshin dhe u kufizoheshin lëvizjet dhe se ata nuk kishin mundësi të ripërtërinin dhe zhvillonin bashkësinë e tyre. Për Gjykatën kushtet në të cilat kjo popullsi ishte 'dënuar' të jetonte ishin përulëse dhe shkelnin thelbin e nocionit të respektimit të dinjitetit njerëzor të anëtarëve të saj. Trajtimi diskriminues arrinte pra në një nivel ashpërsie sa përbënte një trajtim degradues.
- 12. Gjykata vendosi në vijim se, në një vështrim të përgjithshëm, ka pasur shkelje të Nenit 8 në lidhje me të drejtën e greko-qipriotëve të jetonin në veri të Qipros për respektimin e jetës së tyre private dhe familjare. Në këtë trajtim Gjykata vuri në dukje se popullsia në fjalë i ishte nënshtuar kufizimeve serioze në ushtrimin e këtyre të drejtave, përfshirë këtu mbikëqyrjen e lëvizjeve dhe të kontakteve të anëtarëve të saj. Mbikëqyrja e autoriteteve arriti deri në një prani fizike të agjentëve të sigurimit në shtëpitë e greko-qipriotëve në rastet e vizitave nga persona të tjerë, përfshirë këtu edhe të afërm të familjes.
- 13. Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 13 për shkak të mungesës, në praktikë, të mjeteve efektive ndaj ndërhyrjeve nga ana e autoriteteve në të drejtat e greko-qipriotëve që jetonin në veri të Qipros, të drejta të garantuara nga Nenet 3, 8, 9 dhe 10 të Konventës dhe të Neneve 1 dhe 2 të

Protokollit 1.

14. Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të Nenit 2 të Konventës të pretenduar për shkak të një praktike të mohimit të ofrimit të shërbimit mjekësor ndaj greko-qipriotëve dhe maronitëve që jetonin në veri të Qipros dhe nuk ka pasur as shkelje të Nenit 5. Në vijim ajo vendosi që nuk ka pasur as shkelje të Neneve 6, 11, dhe Nenit 1 të Protokollit 1.

d) të drejtat e turko-qipriotëve, përfshirë edhe anëtarët e komunitetit cigan, që jetojnë në veri të Qipros

15. Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 6 në lidhje me praktikën ligjore të autorizimit të gjykimit të civilëve nga gjykatat ushtarake.

C. Në lidhje me Nenin 41

16. Gjykata vlerësoi se çështja e zbatimit të Nenit 41 të Konventës në këtë rast nuk ishte gati për t'u vendosur dhe e shtyu atë për një kohë më të vonë.

III. Koment

17. Një aspekt interesant i vendimit të Gjykatës është ai që megjithëse qeveria Turke nuk u paraqit përpara Gjykatës dhe për këtë arsyе nuk parashtroi pretendimet paraprake që ajo kishte ngritur, megjithëse pa sukses, përpara Komisionit në lidhje me pranueshmërinë, Gjykata procedoi sidoqoftë me rishikimin e vendimit të Komisionit në lidhje me këto pretendime. Gjykata hodhi poshtë pretendimet e ngritura nga ana e qeverisë Turke përpara Komisionit sipas të cilave qeveria qipriote nuk kishte *locus standi*¹ për të paraqitur një kërkesë përpara organeve të Strasburgut me arsyetimin se ajo nuk ishte qeveria e ligjshme e Qipros dhe se Turqia nuk mund të ngarkohej me përgjegjësi në bazë të Konventës për akte të "Qipros së Veriut" të përshkruar nga ana e Turqisë si 'shtet i pavarur i krijuar nga bashkësia Turko-Qipriote në ushtrimin e së drejtës së saj për vetëvendosje'.

18. Gjykata vuri në dukje se, në përputhje me vendimin e saj në lidhje me çështjen *Loizidou kundër Turqisë*² bashkësia ndërkombëtare nuk e kishte njojur "Qipron e Veriut" si shtet në bazë të së drejtës ndërkombëtare dhe se Republika e Qipros ngelet i vetmi entitet shtetëror dhe qeverisës i Qipros, gjë e cila i mundëson asaj paraqitjen e ankimeve se ky në trajtim e sipër përpara Gjykatës. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se fakti që Republika e Qipros ngelej i vetmi entitet dhe qeverisje e ligjshme nuk e përjashton Turqinë nga përgjegjësia në bazë të Konventës. Në të kundërt, Gjykata ripohoi argumentimin e saj në çështjen Loizidou sipas së cilët koncepti i 'juridikcionit' në bazë të Nenit 1 të Konventës nuk kufizohet në territorin kombëtar të shtetit palë por mund të shtrihet edhe në zona që janë nën kontrollin e tij efektiv si rezultat i veprimeve ushtarake qofshin këto të

¹ Nga latinishtja – legjitimim sipas konceptimit ligjor shqiptar, pra aftësia për t'u paraqitur si palë dhe ngritur një pretendim qoftë edhe të ligjshëm përpara një organi administrativ apo gjyqësor.

² Vendim i 18 dhjetorit 1996.

ligjshme apo jo. Për më tepër, Gjykata vendosi se pasur parasysh kontrollin efektiv që Turqia ushtron te në Qipron e Veriut, përgjegjësia e saj nuk mund të kufizohej vetëm në aktet e ushtarëve ose oficerëve të saj por shtrihej gjithashtu edhe në aktet e administratës lokale që mbijeton në këtë territor në sajë të mbështetjes Turke ushtarake dhe të një natyre tjetër. Gjykata arriti në përfundimin se, sipas Nenit 1, përgjegjësia e Turqisë shtrihet në sigurimin e "gamës tërësore të të drejtave materiale të parashikuara në Konventë dhe në Protokollet shtesë që ajo ka ratifikuar". Gjykata vuri në dukje se një përfundim i tillë kërkohej nga një Konventë e hartuar për të mbrojtur të drejtat e individit dhe, duke pasur parasysh pamundësinë e vazhdueshme të qeverisë Qipriote për të ushtruar detyrimet e saj ë bazë të Konventës në territoret e Qipros së veriut, çdo përfundim tjetër 'do të conte në një vakum të dëmshëm në lidhje me sistemin e mbrojtjes të të drejtave të njeriut'.

19. Megjithatë, është e rëndësishme të vihet në dukje se Gjykata shkoi edhe më tej në qëndrimin e saj se konstatimet e mësipërme nuk përjashtojnë domosdoshmërisht detyrimin e individëve për të shteruar fillimisht mjetet e brendshme efektive të ofruara nga regjimi i Qipros së Veriut, siç kerkohet nga ish Neni 26 i Konventës. Gjykata u bazua gjithashtu në Mendimin këshillimor të dhënë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në çështjen Namibiane si me vlerë për të ripohuar qëndrimin se e drejta ndërkombëtare njeh legjimitetin e disa zgjidhjeve ligjore të tilla si ajo në Qipron e Veriut. Për më tepër, Gjykata e vlerësoi këtë qëndrim si të preferueshëm, përderisa mosnjohja e akteve të organeve që ekzistojnë në realitet, të tilla si organet gjyqësore të Qipros së Veriut, do të thoshte një mohim ndaj banorëve të Qipros së Veriut edhe i standardit minimum të të drejtave titullarë të të cilave ata janë. Gjykata arriti në përfundimin se mjetet ankimore efektive të mundshme në Qipron e Veriut mund të konsiderohen si mjete të brendshme dhe se efektiviteti i tyre mund të vlerësohet në rrethanat e posaçme të secilës çështje.

20. Duke u rikthyer në konstatimet materiale të Gjykatës në këtë rast, mund të thuhet se kjo ripohoi interpretimet e mëparshme të një numri nenesh të Konventës. Konstatimet e saj në lidhje me Nenin 2 janë mjaft domethënëse përderisa ato përforcijnë qëndrimin se një shtet mund të jetë në shkelje të Nenit 2 kur del në pah se autoritetet e venë jetën e individit në rrrezik me anë të mohimit të kujdesit mjekësor që ata do të kishin ofruar ndaj popullsisë në përgjithësi. Në këtë çështje Gjykata nuk ishte në gjendje të konstatonte se autoritetet me qëllim vunë në jetë një trajtim ose zbatuan një praktikë që vononte vlerësimin e kérkesave të disa pacientëve. Është interesante të shihet se, në përgjigje të një pretendimi për kujdes të pamjaftueshëm mjekësor në veri, Gjykata nuk e trajtoi tërësisht problemin e masës deri në të cilën Neni 2 e detyron një shtet palë në lidhje me ofrimin e kujdesit mjekësor, duke e lënë kështu të hapur mundësinë e eksplorimit të mëtejshëm të parametrave të Nenit 2 në të ardhmen.

21. Gjykata ripohoi gjithashtu se vuajtja e vazhdueshme e familjeve të personave të zhdukur mund të përbënte një shkelje të Nenit 3 të Konventës në disa rrethana. Gjykata vuri në dukje se thelbi i një shkeljeje nuk qëndron

aq shumë në faktin e 'zhdukjes' së anëtarëve të familjes por më tepër të reagimin autoriteteve shtetërore kur situata u bëhet atyre e njohur. Është pikërisht në lidhje me qëndrimin e autoriteteve që i afërti i personit të zhdukur mund të pretendojë drejtpërdrejtë të jetë i dëmtuar nga një shkelje e Nenit 3 të Konventës nga ana e një shteti.

22. Vlerësimi nga Gjykata i çështjeve të Nenit 2 të Protokollit 1 është interesant përsa i përket faktit se, megjithëse ajo nuk vlerëson se koncepti i së drejtës për të mësuar shtrihet edhe ndaj mësimit në një gjuhë të caktuar, thekson se mungesa e autoriteteve të Qipros së Veriut për të parashikuar mundësinë e mësimit në gjuhën greke në shkollën tetëvjeçare përbën 'në fakt mohim të thelbit të kësaj të drejte' përderisa ajo ishte njohur në shkollën fillore. Në parim Gjykata po përpinqej në këtë çështje që të vlerësonë nëse mundësia për të mësuar në gjuhën greke jashtë juridiksionit turk (pra në jug) ishte e mjaftueshme për të përbushur kërkesat e Nenit 2 të Protokollit 1. Megjithatë pasur parasysh ndërhyrjen në këtë rast ndaj së drejtës për jetë familjare si dhe pamundësinë për t'u kthyer në veri, kjo mundësi u konsiderua si e pamjaftueshme.

23. Si përfundim, Gjykata afirmoi se një kërkesë për një trajtim diskriminues mund të jetë aq e ndjeshme sa të arrijë deri në trajtim degradues të papajtueshëm me Nenin 3 dhe se pikërisht një gjë të tillë provat e nxorën në pah në rastin e greko-qipriotëve që jetonin në zonën e Karpas në Qipron e Veriut.